



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

**VENDIM**

**Nr. 146, datë 11.12.2019**

**PËR MIRATIMIN E EKSPERTËVE PËR VLERËSIMIN E NIVELIT TË ZOTËRIMIT TË GJUHËVE TË HUAJA, TË DEKLARUARA NGA KANDIDATËT E LEJUAR PËR VENDIN VAKANT TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 229 dhe të pikës 5 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pikës 44 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ekspertëve për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja, të deklaruara nga kandidatët e lejuar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si më poshtë:

- a) Dr. Ogerta Stroka (Koruti), pedagoge e brendshme e gjuhës angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
- b) Prof.As. Aida Gjinali, pedagoge e brendshme e gjuhës italiane, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**  
**Ardian DVORANI**